LIGJ
Nr.9671, datë 29.12.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE "PËR PROGRAMIN VJETOR TË VEPRIMIT CARDS 2006 PËR SHQIPËRINË""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane "Për programin vjetor të veprimit CARDS 2006 për Shqipërinë"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5184, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE FINANCIARE
KUSHTET SPECIFIKE

Komuniteti Europian, këtu e tutje referuar si "Komuniteti", i përfaqësuar nga Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtu e tutje referuar si "Komisioni", nga njëra anë

dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, këtu e tutje referuar si "Përfituesi", nga ana tjetër,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1
Natyra dhe qëllimi i veprimit

1.1 Komuniteti do të kontribuojë për financimin e programit "Programi vjetor i veprimit CARDS 2006 për Shqipërinë", këtu e tutje referuar si "Programi", i cili është përshkruar në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II.

1.2 Ky program do të zbatohet në përputhje me Marrëveshjen financiare dhe shtojcat e saj: kushtet e përgjithshme (shtojca I) dhe dispozitat teknike dhe administrative (shtojca II).

Neni 2
Kontributi financiar i Komunitetit

2.1 Kostoja totale e programit është 42.500.000 €.

2.2 Komuniteti merr përsipër financimin në shumën maksimale prej 42.5 milionë euro. Ndarja e kontributit financiar të Komunitetit, sipas zërave të buxhetit, është përshkruar në buxhetin e përfshirë në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II.

Neni 3
Kontributi i përfituesit

Aty ku kontributi i Përfituesit është i një natyre jofinanciare, rregullat e detajuara do të përcaktohen në dispozitat teknike dhe administrative të shtojcës II të Marrëveshjes financiare.

Neni 4
Periudha e ekzekutimit

Periudha e ekzekutimit të Marrëveshjes financiare do të fillojë në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë më 31.12.2014. Kjo periudhë ekzekutimi do të përfshijë dy faza: një fazë operative të zbatimit, e cila do të fillojë në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë më 31.12.2012. Nga kjo datë do të fillojë faza e mbylljes, e cila do të përfundojë në fund të periudhës së ekzekutimit.

Neni 5
Afati për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes financiare

Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare do të nënshkruhen brenda afatit maksimal, 11.8.2009. Ky afat nuk mund të shtyhet. Kjo dispozitë nuk zbatohet për kontratat e auditit dhe vlerësimit, të cilat mund të nënshkruhen më vonë.

Neni 6
Adresat

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes financiare do të jenë me shkrim, duke iu referuar shprehimisht programit dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

a) Për Komisionin:
Z. Reinhard Priebe
Drejtor
Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit
CHAR 04/188
B-1049 Bruksel
Faks: +32 2 296 9825

b) Për Përfituesin:
Znj. Arenca Trashani
Ministre e Integrimit Europian
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri
Faks: +355 4 25 62 67

Neni 7
Shtojcat

7.1 Dokumentet e mëposhtme do t’i bashkëlidhen kësaj Marrëveshjeje dhe do të bëhen pjesë

përbërëse të saj:

Shtojca I: Kushtet e përgjithshme;

Shtojca II: Dispozitat teknike dhe administrative.

7.2 Në rast të një mospërputhjeje midis dispozitave të shtojcave dhe atyre të kushteve specifike të Marrëveshjes financiare, dispozitat e kushteve specifike do të kenë përparësi. Në rast të një mospërputhjeje midis dispozitave të shtojcës I dhe atyre të shtojcës II, dispozitat e shtojcës I do të kenë përparësi.

Neni 8

Bashkëpunimi nga ana e Përfituesit

8.1 Kushtet e përgjithshme plotësohen nga dispozitat e mëposhtme:

Me qëllim që të sigurohet një zbatim efektiv i kësaj Marrëveshjeje financiare, Përfituesi do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që:

- ekspertët e kontraktuar nga Komisioni për zbatimin e programit, lidhur me këtë Marrëveshje financiare, do të gëzojnë mbrojtjen e tij dhe do t'u jepen lejekalimet e nevojshme për të bërë të mundur lëvizjen e lirë të tyre brenda territorit të Shqipërisë;

- të gjithë personelit që merr pjesë në zbatimin e programit dhe anëtarëve të afërt të familjeve të tyre mund t'u akordohen përfitime jo më pak të favorshme, privilegje dhe përjashtime, si ato që u akordohen zakonisht të punësuarve të tjerë të stafit ndërkombëtar në Shqipëri, sipas çdo marrëveshjeje dypalëshe ose shumëpalëshe për ndihmë ekonomike;

- të gjithë personelit që merr pjesë në zbatimin e programit dhe anëtareve të afërt të familjeve të tyre u lejohet hyrja në Shqipëri për t'u vendosur për të punuar dhe për t'u larguar nga Shqipëria, siç parashikohet në kontratë;

- të jepen të gjitha lejet e nevojshme për importimin e pajisjeve për këtë program, si dhe lejet e kërkuara për rieksportimin e po këtyre artikujve;

- të gjitha importet e kryera nën këtë Marrëveshje financiare të përjashtohen nga taksat e doganave, detyrimet eksportuese ose taksa dhe tarifa të tjera fiskale;

- të gjitha prokurimet publike të pajisjeve dhe shërbimeve të zhvilluara nën këtë Marrëveshje financiare të përjashtohen nga taksat e shitjeve ose tarifat e tjera fiskale të së njëjtës natyrë;

- në të gjitha këto raste, Përfituesi do të sigurojë bashkëpunim të plotë me autoritetet përkatëse;

- përveç të tjerash, Përfituesi do të sigurojë akses në kompanitë shtetërore dhe institucionet e tjera qeverisëse, të cilat do të përfshihen ose janë të nevojshme për zbatimin e programit.

Në rast vështirësish në zbatimin e programit, Palët bien dakord të konsultohen menjëherë, me qëllim që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të zgjidhur këto vështirësi.

Importimi dhe rieksportimi i pajisjeve

Përfituesi do të japë lejet e nevojshme për importimin e pajisjeve profesionale të kërkuara për të ekzekutuar masat që i nënshtrohen ligjeve ekzistuese, rregullave dhe rregulloreve të marrësit.

Përfituesi do t'u japë personave fizikë dhe juridikë që kanë ofruar punime, pajisje ose kontrata shërbimesh, lejet e kërkuara për rieksportimin e pajisjeve në fjalë.

8.2 Neni 7 i kushteve të përgjithshme do të zëvendësohet si më poshtë:

Neni 7

Pranueshmëria

1. Pjesëmarrja në ftesat për prokurime ose kontrata granti të financuara nga programi CARDS do të jetë e hapur për:

a) personat, fizikë dhe juridikë, të cilët janë vendosur në njërin nga shtetet anëtare të Komunitetit Europian, në njërin nga vendet e njohura nga Komuniteti Europian si kandidat zyrtar ose në njërin nga vendet i cili është përfitues nën rregulloren e Këshillit 2666/2000 të 5 dhjetorit 2000 (rregullorja CARDS), si dhe personat juridikë, të cilët janë vendosur në njërin nga vendet anëtare të zonës ekonomike europiane;

b) personat fizikë dhe juridikë, të cilët janë vendosur në njërin nga vendet tashmë të pranueshme nga rregullorja CARDS;

c) personat juridikë, të cilët janë vendosur në njërin nga vendet në zhvillim, siç është specifikuar në listën e Komitetit të Ndihmës për Zhvillim të OBZHE-së, në shtojcën II të rregullores së Këshillit 2112/2005 të datës 21 nëntor 2005 dhe të cilat janë përmendur shprehimisht si të pranueshme në rregulloren CARDS;

d) personat juridikë, të cilët janë vendosur në një vend tjetër nga ato të referuara në nënparagrafët a, b dhe c, ku aksesi reciprok në ndihmën e tyre të huaj është vendosur në bazë të nenit 6 të rregullores së Këshillit 2112/2005 të datës 21 nëntor 2005;

e) organizatat ndërkombëtare.

2. Sa herë që fondet e Komunitetit mbulojnë një veprim të zbatuar nëpërmjet një organizate ndërkombëtare, pjesëmarrja në ftesat për prokurime ose kontrata granti do të jetë e hapur për të gjithë personat juridikë, të cilët janë të pranueshëm në bazë të paragrafit 1, si dhe të gjithë personat juridikë, të cilët janë të pranueshëm në bazë të rregullave të organizatave ndërkombëtare, duke treguar kujdes që të sigurohet trajtim i barabartë për të gjithë donatorët. Të njëjtat rregulla do të zbatohen edhe për sa i takon pajisjeve, materialeve dhe ekspertëve.

3. Sa herë që fondet e Komunitetit mbulojnë një veprim të bashkëfinancuar me një vend të tretë, objekt i reciprocitetit siç është përcaktuar në paragrafin 1 nënparagrafi “d”, ose me një organizatë rajonale apo vend anëtar të BE-së, pjesëmarrja në ftesat për prokurime ose kontrata granti do të jetë e hapur për të gjithë personat juridikë, të cilët janë të pranueshëm në bazë të rregullave të këtyre vendeve të treta, organizatave rajonale ose vendeve anëtare. Të njëjtat rregulla do të zbatohen edhe për sa i takon pajisjeve, materialeve dhe ekspertëve.

4. Të gjitha pajisjet dhe materialet e blera nën një kontratë të financuar nga programi CARDS duhet ta kenë prejardhjen nga Komuniteti ose nga një vend i pranueshëm, siç është përcaktuar në paragrafin 1 nënparagrafi “a”, “b”, “c” dhe “d”. Termi “prejardhje”, për qëllim të këtij paragrafi, është përcaktuar në legjislacionin përkatës të Komunitetit mbi rregullat e origjinës për qëllime doganore.

Në raste të jashtëzakonshme, Komisioni:

a) mund të pranojë pjesëmarrjen e personave juridikë nga një vend i cili nuk është përfshirë në paragrafin 1, nënparagrafët “a”, “b”, “c” dhe “d”;

b) mund të lejojë blerjen e pajisjeve dhe materialeve që e kanë prejardhjen nga një vend i cili nuk është përfshirë në paragrafin 1, nënparagrafët “a”, “b”, “c” dhe “d”;

c) kufizimet, siç është parashikuar në nënparagrafët “a” dhe “b”, mund të justifikohen në bazë të mospasjes në dispozicion të prodhimeve dhe shërbimeve në tregun e vendit në fjalë, për arsye tepër urgjente ose nëse rregullat e pranueshmërisë do ta bënin realizimin e projektit, programit ose veprimit të pamundur apo tej mase të vështirë.

6. Të gjithë ekspertët e angazhuar nga tenderuesit, siç përcaktohet në paragrafët 1 dhe 3, mund të jenë të çfarëdo kombësie.

Ky paragraf nuk cenon kërkesat e cilësisë dhe ato financiare, të parashtruara në rregullat e prokurimit të Komunitetit.

Neni 9

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes financiare

Marrëveshja financiare do të hyjë në fuqi në datën në të cilën ajo nënshkruhet nga Pala e fundit e dyja Palëve.

Bërë në dy kopje origjinale, në gjuhën angleze, një kopje për Komisionin dhe një kopje për Përfituesin.

PËR PËRFITUESIN:	PËR KOMISIONIN:
Znj. Arenca Trashani	Z. Reinhard Priebe
Ministre e Integrimit Europian	Drejtor
Tiranë	Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit
	Bruksel
Data	Data 11 gusht 2006

Deklarim. Për sa i përket nenit 9, kjo Marrëveshje financiare do të hyjë në fuqi për Palën Shqiptare ditën që ratifikohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

Ministre e Integrimit Europian

Arenca Trashani

SHTOJCA I
KUSHTET E PËRGJITHSHME

SEKSIONI I
FINANCIMI I PROJEKTIT/PROGRAMIT

Neni 1
Parime të përgjithshme

1.1 Kontributi financiar i Komunitetit do të kufizohet nga shuma e përcaktuar në Marrëveshjen financiare.

1.2 Dhënia e financimit nga Komuniteti do t'i nënshtrohet plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje financiare nga ana e Përfituesit.

Neni 2
Tejkalimi i kostove dhe mbulimi i tyre

2.1 Tejkalimet individuale të zërave të buxhetit të Marrëveshjes financiare do të trajtohen me anë të rishpërndarjes së fondeve të buxhetit të përgjithshëm, në përputhje me nenin 17 të këtyre kushteve të përgjithshme.

2.2 Në qoftë se ekziston një rrezik i tejkalimit të shumës totale të përcaktuar në Marrëveshjen financiare, Komisioni mund të zvogëlojë projektin/programin ose të kërkojë angazhimin e burimeve financiare të Përfituesit apo burime të tjera jokomunitare.

2.3 Në qoftë se projekti/programi nuk mund të zvogëlohet ose në qoftë se tejkalimi nuk mund të mbulohet as nga fondet e Përfituesit apo burime të tjera, Komisioni mund të japë në mënyrë të jashtëzakonshme financime komunitare shtesë. Në këtë rast, kostot shtesë do të financohen pa cenuar rregullat dhe procedurat e Komunitetit, duke çelur një kontribut financiar shtesë, i cili do të përcaktohet nga Komisioni.

SEKSIONI II
ZBATIMI

Neni 3
Parime të përgjithshme

3.1 Projekti/programi do të zbatohet nga Komisioni duke vepruar për dhe në emër të Përfituesit.

3.2 Komisioni do të përfaqësohet në shtetin e Përfituesit nga kryetari i delegacionit të tij.

Neni 4
Periudha e ekzekutimit

4.1 Periudha e ekzekutimit të Marrëveshjes financiare do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë në datën e përcaktuar në nenin 4 të kushteve specifike.

4.2 Kjo periudhë ekzekutimi do të përfshijë dy faza:

- një fazë operative zbatimi, ku kryhen veprimtaritë kryesore. Kjo fazë do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë jo më vonë se 24 muaj para përfundimit të kohës së ekzekutimit;
- faza e mbylljes, gjatë së cilës do të kryhen kontrollet financiare dhe vlerësimi, si dhe do të mbyllen teknikisht dhe financiarisht kontratat për zbatimin e Marrëveshjes financiare. Kjo fazë do të fillojë në datën e përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe do të përfundojë jo më vonë se 24 muaj

pas kësaj date.

4.3 Kostot që rrjedhin nga aktivitetet kryesore do të jenë të pranueshme për financim nga ana e Komunitetit vetëm në qoftë se ato kanë lindur gjatë fazës operative të zbatimit. Kostot që rrjedhin nga kontrolli financiar përfundimtar, vlerësimi dhe mbyllja e aktiviteteve do të jenë të pranueshme deri në fund të fazës së mbylljes.

4.4 Çdo fond i mbetur nga kontributi i Komunitetit do të anulohet automatikisht gjashtë muaj pas përfundimit të periudhës së ekzekutimit.

4.5 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e fazës operative të zbatimit dhe, rrjedhimisht, të periudhës së ekzekutimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj para përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe të miratohet nga Komisioni para kësaj date.

4.6 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet dhe pas përfundimit të fazës operative të zbatimit, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e afatit të fazës së mbylljes dhe, rrjedhimisht, të periudhës së ekzekutimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të bëhet të paktën tre muaj para përfundimit të fazës së mbylljes dhe të miratohet nga Komisioni para kësaj date.

SEKSIONI III
LIDHJA E KONTRATAVE DHE DHËNIA E GRANTEVE

Neni 5
Parime të përgjithshme

Të gjitha kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare duhet të lidhen në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për zbatimin e operacioneve të jashtme në fuqi, në momentin e nisjes së procedurave në fjalë.

Neni 6
Afati përfundimtar për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes financiare

6.1 Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare do të nënshkruhen nga të dyja Palët brenda tre vjetësh nga miratimi i angazhimit buxhetor nga Komisioni, pra e shumta deri në datën e caktuar në nenin 5 të kushteve specifike. Ky afat nuk mund të shtyhet.

6.2 Dispozita e mësipërme nuk do të zbatohen për kontratat e kontrollit financiar dhe të vlerësimit, të cilat mund të nënshkruhen edhe më vonë.

6.3 Në datën e përmendur në nenin 5 të kushteve specifike, çdo fond, për të cilin nuk është nënshkruar ndonjë kontratë, do të anulohet.

6.4 Çdo kontratë, për të cilën nuk ka filluar asnjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj, do të përfundojë automatikisht dhe fondet e saj do të anulohen.

Neni 7
Pranueshmëria

7.1 Pjesëmarrja në ftesat për tendera për kontratat për punime, furnizime ose shërbime, është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi tjetër të tretë të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.2 Pjesëmarrja në kërkesat për propozime është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi tjetër të tretë të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.3 Në mënyrë të jashtëzakonshme, në raste të justifikuara, të miratuara nga Komisioni, mund të vendoset që, në bazë të kushteve specifike të përcaktuara në aktet bazë rregulluese të sektorëve të

interesuar të bashkëpunimit, të lejohen shtetasit e vendeve të treta, të ndryshëm nga ata të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2, të marrin pjesë në tenderat për kontrata.

7.4 Mallrat dhe furnizimet e financuara nga Komuniteti dhe të nevojshme për përmbushjen e kontratave të punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve, si dhe të procedurave të prokurimit të ndërmarra nga përfituesi i grantit për ekzekutimin e aktivitetit të financuar, duhet ta kenë origjinën e tyre në vende të pranueshme për pjesëmarrje, siç përcaktohet në tre paragrafët e mësipërm.

7.5 Ky rregull i kombësisë do të zbatohet gjithashtu për ekspertët e propozuar nga ofruesit e shërbimeve, të cilët marrin pjesë në procedurat e tenderave ose në kontratat e shërbimeve të financuara nga Komuniteti.

SEKSIONI IV
RREGULLAT E ZBATUESHME PËR PËRMBUSHJEN E KONTRATAVE

Neni 8
Vendosja dhe e drejta e qëndrimit

8.1 Kur justifikohet nga natyra e kontratës, personat fizikë dhe juridikë që marrin pjesë në ftesat për tendera për kontratat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve, do të gëzojnë të drejtën e përkohshme të vendosjes dhe qëndrimit në vendin e Përfituesit. Kjo e drejtë do të jetë e vlefshme për një muaj pas lidhjes së kontratës.

8.2 Kontraktuesit (duke përfshirë përfituesin e grantit) dhe personat fizikë, shërbimet e të cilëve janë të nevojshme për përmbushjen e kontratave, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, do të gëzojnë të drejta të ngjashme gjatë zbatimit të projektit/programit.

Neni 9
Normat tatimore dhe doganore

9.1 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kushtet specifike, tatimet, detyrimet doganore dhe detyrime të tjera (duke përfshirë TVSH-në ose taksa të barazvlefshme) do të jenë të përjashtuara nga financimi i Komunitetit.

9.2 Shteti përfitues do të zbatojë, për kontratat e prokurimeve dhe grantet e financuara nga Komuniteti, normat tatimore dhe doganore më të favorizuara, të zbatueshme për shtetet ose organizatat e zhvillimit ndërkombëtar me të cilat ka marrëdhënie.

9.3 Aty ku Marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato do të aplikohen gjithashtu.

Neni 10
Normat mbi kursin e këmbimit

10.1 Shteti Përfitues merr përsipër të autorizojë importin ose blerjen e valutës së huaj të nevojshme për zbatimin e projektit. Ai merr përsipër gjithashtu të zbatojë normativën e tij kombëtare për këmbimin e valutës në një mënyrë jodiskriminuese për kontraktuesit që lejohen të marrin pjesë sipas nenit 7 të këtyre kushteve.

10.2 Aty ku Marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të aplikohen gjithashtu.

Neni 11
Përdorimi i të dhënave nga studimet

Aty ku Marrëveshja financiare përfshin financimin e një studimi, kontrata në lidhje me këtë studim, nënshkruar për zbatimin e Marrëveshjes financiare, do të rregullojë pronësinë e këtij studimi, si dhe të drejtat e Përfituesit dhe të Komisionit për të përdorur të dhënat në studim, për t'i publikuar ato ose për t'iua dhënë palëve të treta.

Neni 12
Alokimi i fondeve të rikthyera nga kontratat

12.1 Fondet e rikthyera nga pagesat e kryera gabimisht, nga garancitë e pagesave parafinancuese ose nga përfitimet që rrjedhin nga garancitë e ofruara në bazë të kontratave të financuara sipas kësaj Marrëveshjeje financiare, do të alokohen për projektin/programin.

12.2 Gjobat financiare të vendosura nga autoriteti kontraktues ndaj një kandidati apo pjesëmarrësi në tender, i cili hyn në rastet e përjashtimit në kuadrin e një kontrate prokurimi, kërkesa për garancitë e tenderit, si dhe dëmet që i shkaktohen Komisionit, do t'i ripaguhen buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane.

SEKSIONI V
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13
Transparenca

13.1 Çdo projekt/program i financuar nga Komuniteti do të jetë objekt i veprimeve të përshtatshme informuese dhe komunikuese. Këto veprime do të përcaktohen me miratimin e Komisionit.

13.2 Këto operacione informuese dhe komunikuese duhet të kryhen sipas rregullave të përcaktuara e të publikuara nga Komisioni për transparencën e aktiviteteve të jashtme në fuqi në momentin e kryerjes së këtyre veprimeve.

Neni 14
Parandalimi i parregullsive, mashtrimit dhe korrupsionit

14.1 Përfituesi do të marrë masat e përshtatshme për të parandaluar parregullsitë dhe mashtrimet dhe me kërkesë të Komisionit, do të nisë ndjekjet penale për rikthimin e fondeve të paguara gabimisht. Përfituesi do të informojë Komisionin për çdo masë të marrë.

14.2 "Parregullsi" do të nënkuptojë çdo shkelje të Marrëveshjes financiare, kontratave të zbatimit ose të së drejtës komunitare, e cila shkaktohet si pasojë e një veprimi ose mosveprimi të një operatori ekonomik dhe që ka ose do të kishte si pasojë cenimin e buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane ose të buxheteve të administruara prej tyre, duke pakësuar ose duke humbur të ardhura që rrjedhin nga burime të tyre të mbledhura direkt në emër të Komuniteteve Europiane apo nga çdo zë i pajustifikuar shpenzimi.

"Mashtrim" do të nënkuptojë çdo veprim ose mosveprim të qëllimshëm, që lidhet me:

- përdorimin ose paraqitjen e dokumenteve apo deklaratave të rreme, jo korrekte ose të paplota, të cilat kanë si efekt të tyre përvetësimin apo mbajtjen e padrejtë të fondeve nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Europiane apo nga buxhetet e administruara prej tyre ose në emër të tyre;
- mosdhënien e informacionit, në kundërshtim me detyrimet specifike, me efekt të njëjtë;
- keqpërdorimin e këtyre fondeve për qëllime të tjera, të ndryshme nga ato për të cilat janë ofruar fillimisht.

Përfituesi do të informojë menjëherë Komisionin për çdo element që sillet në vëmendjen e tij, i cili lë për të dyshuar për parregullsi ose mashtrim.

14.3 Përfituesi merr përsipër të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të ndrequr çdo praktikë korruptive, pasive ose aktive, çfarëdo qoftë ajo, në çdo fazë të procedurës për lidhjen e kontratave ose dhënien e granteve ose në zbatimin e kontratave që lidhen me të. "Korrupsion pasiv" do të thotë veprim i paramenduar i një nëpunësi, i cili, direkt ose me anë të një ndërmjetësi, kërkon ose përfiton avantazhe të çdo lloji, çfarëdo qoftë ky, për veten e tij ose për një palë të tretë, ose pranon një premtim për një përfitim të tillë, për të vepruar ose për t'u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij apo në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cenimin e interesave financiare të Komuniteteve Europiane. "Korrupsion aktiv" do të thotë veprim i paramenduar i cilitdo që, direkt apo nëpërmjet një ndërmjetësi, i premton ose i jep një

avantazh të çdo lloji, çfarëdo qoftë ai, një nëpunësi për veten e tij ose për një palë të tretë, për të vepruar ose për t'u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cenimin e interesave financiare të Komuniteteve Europiane.

Neni 15

Verifikimet dhe kontrollet nga Komisioni, Zyra Europiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe Gjykata e Audituesve e Komuniteteve Europiane

15.1 Përfituesi bie dakord që Komisioni, OLAF dhe Gjykata e Audituesve e Komuniteteve Europiane të kryejnë kontrolle dokumentacioni apo në vend mbi përdorimin që i është bërë financimit të Komunitetit sipas Marrëveshjes financiare (duke përfshirë procedurat për lidhjen e kontratave dhe dhënien e granteve), si dhe të kryejnë një kontroll financiar të plotë, nëse është e nevojshme, në bazë të dokumenteve mbështetëse të llogarive dhe dokumenteve kontabël, si dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me financimin e projektit/programit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes, si dhe për shtatë vjet pas datës së pagesës së fundit.

15.2 Përfituesi bie dakord gjithashtu që OLAF mund të kryejë kontrolle në vend dhe verifikime në përputhje me procedurat e përcaktuara nga e drejta komunitare për mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Europiane kundër mashtrimit dhe parregullsive të tjera.

15.3 Për këtë qëllim, Përfituesi merr përsipër t'u japë nëpunësve të Komisionit, të OLAF dhe të Gjykatës së Audituesve të Komuniteteve Europiane, si dhe përfaqësuesve të tjerë të autorizuar, mundësinë e hyrjes në vendet dhe ambientet në të cilat janë kryer aktivitetet e financuara sipas Marrëveshjes financiare, duke përfshirë sistemet e tyre kompjuterike, si dhe çdo dokument ose të dhënë të informatizuar që lidhet me administrimin teknik dhe financiar të këtyre aktiviteteve, si dhe të marrë përsipër çdo masë që është e nevojshme për të lehtësuar punën e tyre. Kjo mundësi hyrjeje për përfaqësuesit e autorizuar të Komisionit Europian, të OLAF-it dhe Gjykatës së Audituesve të Komuniteteve Europiane do të jepet në kushtet e një konfidencialiteti të plotë lidhur me palët e treta, duke mos cenuar detyrimet që rrjedhin nga e drejta publike të cilave ato i nënshtrohen. Dokumentet duhet të jenë të konsultueshme dhe të arkivuara në mënyrë që të inspektohen lehtësisht. Përfituesi është i detyruar të njoftojë Komisionin, OLAF-in ose Gjykatën e Auditorëve të Komuniteteve Europiane për vendin e saktë ku ruhen këto dokumente.

15.4 Kontrollet dhe kontrollet financiare të përmendura më sipër do të zbatohen edhe për kontraktuesit dhe nënkontraktuesit, të cilët kanë përfituar financime të Komunitetit.

15.5 Përfituesi do të njoftohet mbi misionet e kontrollit në vend nga përfaqësuesit e caktuar nga Komisioni, OLAF ose Gjykata e Audituesve.

Neni 16

Konsultimet midis Komisionit dhe Përfituesit

16.1 Përfituesi dhe Komisioni do të konsultohen me njëri-tjetrin përpara paraqitjes së çdo mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje financiare.

16.2 Konsultimet mund të çojnë në amendimin, pezullimin ose përfundimin e Marrëveshjes financiare.

Neni 17

Amendimet në Marrëveshjen financiare

17.1 Çdo amendim në kushtet specifike dhe shtojcën II të Marrëveshjes financiare do të bëhet me shkrim dhe do të jetë objekt i një shtojce.

17.2 Në qoftë se kërkesa për një ndryshim vjen nga Përfituesi, ky i fundit do t'ia paraqesë kërkesën Komisionit të paktën tre muaj përpara datës së propozuar për hyrjen në fuqi të shtojcës, me përjashtim të rasteve të justifikuara siç duhet nga Përfituesi dhe të pranuara nga Komisioni.

17.3 Rastet specifike të zgjatjes së afatit të fazës operative të zbatimit ose fazës së mbylljes rregullohen nga neni 4(5) dhe (6) i këtyre kushteve të përgjithshme.

Neni 18
Pezullimi i Marrëveshjes financiare

18.1 Marrëveshja financiare mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e Marrëveshjes financiare, në qoftë se Përfituesi shkel detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja financiare.

b) Komisioni mund të pezullojë Marrëveshjen financiare, në qoftë se Përfituesi shkel një detyrim që lidhet me të drejtat e njeriut, parimet demokratike dhe shtetin ligjor dhe në rastet serioze të korrupsionit.

c) Marrëveshja financiare mund të pezullohet për shkak të një force madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë madhore" do të thotë një situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, e cila i pengon palët në përmbushjen e çdo detyrimi dhe që nuk mund t'i faturohet një gabimi ose pakujdesie të tyre (ose kontraktuesve, agjentëve ose punonjësve të tyre), si dhe provohet të jetë e pakapërcyeshme, pavarësisht nga përpjekjet që mund të bëhen. Difektet në pajisje ose materiale apo vonesat për t'i bërë të disponueshme, mosmarrëveshjet e punës, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të konsiderohen si forca madhore. Një palë nuk do të konsiderohet në shkelje të detyrimeve të saj, në qoftë se nuk ka mundur t'i përmbushë ato për shkak të një force madhore. Një palë që ballafaqohet me një forcë madhore do të informojë pa vonesë palën tjetër, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe pasojat e parashikuara të problemit dhe do të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme.

18.2 Asnjë njoftim paraprak nuk do të jepet për vendimin e pezullimit.

18.3 Në momentin e njoftimit të pezullimit, do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t'u nënshkruar.

Neni 19
Përfundimi i Marrëveshjes financiare

19.1 Në qoftë se çështjet që shkaktojnë pezullimin e Marrëveshjes financiare nuk zgjidhen për një periudhë katërmujore, çdo Palë mund të përfundojë Marrëveshjen financiare me dy muaj paralajmërim.

19.2 Kur një Marrëveshje financiare nuk ka filluar ndonjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj ose kontratat e zbatimit nuk janë nënshkruar sipas datave të përcaktuara në nenin 5 të kushteve specifike, atëherë Marrëveshja financiare do të mbarojë automatikisht.

19.3 Në momentin e njoftimit të mbarimit, do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t'u nënshkruar.

Neni 20
Masat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

20.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen financiare, e cila nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga konsultimet midis Palëve sipas nenit 16 të këtyre kushteve, mund të zgjidhet me anë të arbitrazhit, me kërkesën e njërës prej Palëve.

20.2 Në këtë rast, secila nga Palët do të caktojë një gjyqtar arbitrazhi brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës për arbitrazh. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga Palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (Hagë) të caktojë një gjyqtar të dytë arbitrazhi. Nga ana e tyre, dy gjyqtarët e arbitrazhit do të caktojnë një gjyqtar të tretë arbitrazhi brenda 30 ditësh. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga Palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit të caktojë gjyqtarin e tretë të arbitrazhit.

20.3 Përveç rastit kur gjyqtarët e arbitrazhit vendosin ndryshe, do të zbatohen procedurat e përcaktuara në rregullat fakultative të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit për Arbitrazhin që përfshin organizatat ndërkombëtare dhe shtetet. Vendimet e gjyqtarëve të arbitrazhit do të merren me shumicë votash brenda një periudhe tremujore.

20.4 Secila Palë do të jetë e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të gjyqtarëve të arbitrazhit.

SHTOJCA II
DISPOZITAT TEKNIKE DHE ADMINISTRATIVE

1. PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT TË VEPRIMIT

Me qëllim kalimin në mënyrë progresive nga asistenca për projekte në asistencë për mbështetje sektoriale dhe brenda kufijve të kuadrit aktual të programimit, konkretisht Dokumenti Strategjik për Shqipërinë 2002-2006 (CSP) dhe Programi Indikativ Shumëvjeçar 2005-2006 (MIP), asistenca e propozuar nën këtë program veprimi, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet shqiptare, fokusohet në tri fusha kryesore:

I Stabilizim demokratik

II Mirëqeverisje dhe ngritje e institucioneve1

III Zhvillim ekonomik dhe social, së bashku me: IV hapjen e programeve komunitare

Ky program vjetor veprimi nuk përmban "EU-CAFAO Albania" dhe "Tempus", të cilat do të financohen nëpërmjet vendimeve të tjera të Komisionit. Shuma totale e parashikuar për Shqipërinë në drejtim të këtyre dy projekteve është përkatësisht 2 milionë dhe 1 milionë euro.

Në linjë me përqasjen e re të mbështetjes sektoriale, fishat e bashkëlidhura me programin e veprimit nuk janë më fisha "projekti", por fisha "sektori". Një përmbledhje e fishave është dhënë më poshtë.

Programi i veprimit konsiston në projekte në sektorët e mëposhtëm prioritarë:

Stabilizimi demokratik – 1.60 milion euro

Historiku

Shqipëria ka qenë e qëndrueshme vitet e fundit dhe duket se ka kapërcyer vitet e krizës 1997-1999. Ngjarja kryesore politike e vitit ishin zgjedhjet parlamentare të mbajtura në fillim të korrikut. Ato u konsideruan në përgjithësi të rregullta dhe çuan në një kalim, megjithëse të vonuar, pa probleme të pushtetit. Kalimi i qetë dëshmoi forcimin e sistemit demokratik në Shqipëri. Megjithatë, një kulturë konsensuale demokratike dhe respekti për shtetin ligjor janë ende të pamjaftueshme.

Kjo situatë i atribuohet pjesërisht zhvillimit të dobët të shoqërisë civile. Megjithëse ekzistojnë shumë OJQ, ato mund të ndërmarrin një shpërndarje të kufizuar të shërbimeve dhe politikave advokuese. Ato kanë mungesë kapacitetesh teknike dhe menaxhuese dhe për arsye të një aftësie të kufizuar për të gjeneruar mbështetje financiare brenda vendit, ende varen në një shkalle të gjerë nga fondet e huaja.

Qeveritë e njëpasnjëshme shqiptare kanë tentuar të influencojnë median, duke ushtruar presion financiar, fiskal etj. Ekziston nevoja për të hartuar, zbatuar dhe konsoliduar një politikë të qartë për mediat, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, ndryshime në legjislacion, me qëllim mbrojtjen e medias nga presione të tilla. Për më tepër, është i nevojshëm përmirësimi i cilësisë së gazetarisë, duke përfshirë këtu edhe mbulimin e çështjeve mbi integrimin europian.

Antitrafikimi dhe menaxhimi i kufirit vazhdojnë të përmirësohen, duke rezultuar në një reduktim të migrimit/trafikut të paligjshëm drejt BE-së nëpërmjet Adriatikut, ndërkohë që brenda vendit trafikimi i femrave dhe të miturve, shpesh i lidhur me trafikun e drogës, është lënë pas dore. Ekziston një hendek midis riintegrimit social të viktimave të trafikut dhe masave për ndërgjegjësimin e publikut, të cilat duhet të merren edhe në zonat e pazhvilluara të Shqipërisë, ku varfëria dhe marzhinalizimi janë shkaqet e këtij fenomeni, për të ulur trafikimin dhe përfshirjen në forma të tjera të krimit të organizuar.

Politikat bashkëpunuese të vendit përfitues

Integrimi i Shqipërisë në BE është duke u realizuar nëpërmjet procesit të Stabilizim-Asociimit

[1] Ky seksion përmbledh 3 elemente: drejtësia dhe çështjet e brendshme, reforma e administratës publike dhe decentralizimi

(Sap).

Në përputhje me strategjinë kombëtare për shërbimet sociale, autoritetet lokale mund t'ia delegojnë dhënien e shërbimeve sociale organizatave të shoqërisë civile. Megjithatë, strategjia nuk mund të zbatohet për arsye të mungesës së financave. Për këtë arsye OJQ-të mund të ofrojnë shërbime komunitare vetëm me fonde të siguruara nga donatorë ndërkombëtarë.

Kushtetuta e Shqipërisë garanton lirinë e shprehjes për mediat. Ekziston një numër i madh gazetash dhe mediash të tjera të shkruara/televizive, por ato mund të jenë objekt presioni financiar dhe politik. Janë përgatitur por ende nuk janë miratuar drafte për përmirësimin e legjislacionit në lidhje me shpifjet dhe median e shkruar. Ka të ngjarë që miratimi i një legjislacioni të balancuar, modern dhe të konkurrueshëm me atë të BE-së të kërkojë ende kohë.

Koherenca me politiken e bashkëpunimit të BE-së

Një nga objektivat kryesorë të programit të veprimit është rritja e pjesëmarrjes në dhe transparenca e SAp, si dhe përgjegjshmëria e qeverisë për politikat e saj të integrimit me BE-në. Synohet të ndihmohet në sigurimin e një mirëqeverisjeje, veçanërisht në fushat e mbuluara nga Sap, të cilat paraqesin mjaft interes për qytetarët shqiptarë.

Kjo pjesë e programit të veprimit, duke nxitur në mënyrë të hapur pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e integrimit, kontribuon në objektivin e përgjithshëm të politikës së Komunitetit për të zhvilluar dhe konsoliduar demokracinë, si dhe të kërkojë të sigurojë gëzimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore nga ana e viktimave të trafikut dhe grupeve të tjera të pafavorizuara. Barazia gjinore njihet si një parakusht për zhvillimin dhe stabilitetin demokratik. Përpjekje të mëtejshme duhet të bëhen për të siguruar që organizatat e shoqërisë civile dhe media të jenë të afta të identifikojnë çështjet e barazisë gjinore në aktivitetet e tyre dhe të formulojnë programe ne përputhje me to.

Koherenca me NIP/MIP

Përqasja është në linjë me MIP 2005-2006, e cila parashikon mbështetje për shoqërinë civile, në mënyrë që të bëhet anëtare në politikat dhe planifikimin strategjik në nivel lokal dhe qendror dhe të mbështesë aktivitetet e tyre dhe që të nxisin zhvillimin ekonomik dhe social, si dhe të mbështesin përmirësimet në politikën e medias.

Projektet e identifikuara

Referenca 1.1: Shoqëria civile dhe media

- Mbështetje për organizatat e shoqërisë civile
- Mbështetje për median shqiptare dhe përfshirja e saj në debatin e politikës europiane

Mirëqeverisja dhe ngritja e institucioneve- 24.30 milionë euro

Ky sektor ndahet në komponentët e mëposhtëm:

Drejtësia dhe çështjet e brendshme

Reforma e administratës publike dhe decentralizimi

A) Drejtësia dhe çështjet e brendshme

Historiku

Sistemi i drejtësisë shqiptare i është nënshtruar reformave serioze në kuadrin legjislativ dhe institucional, duke u fokusuar në miratimin e paketave ligjore për antitrafik, antiterrorizëm dhe antimafie. Pavarësisht përpjekjeve të fundit të Shqipërisë dhe ndihmës së konsiderueshme ndërkombëtare, sektori i drejtësisë dhe i çështjeve të brendshme mbetet problematik dhe qytetarëve ende nuk u është kthyer besimi në këto institucione.

Megjithëse Shqipëria ka ecur përpara në përmirësimin e funksionimit të sistemit të saj gjyqësor përsa i përket organizimit dhe transparencës, funksionimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe zhvillimi i mjeteve legjislative për drejtësinë penale dhe të miturve mbetet i dobët, ndërkohë që pavarësia e gjyqësorit duhet forcuar. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, megjithëse po përmirësohet, është ende i ulët dhe transparenca duhet të përmirësohet. Paga më të larta, si dhe një infrastrukturë e përmirësuar mund të përmirësojnë efektivitetin e stafit të gjyqësorit.

Progres është bërë për përmirësimin e mënyrës se si sistemi gjyqësor trajton drejtësinë penale, në atë që një "paketë antimafie" ka futur instrumente të reja ligjore, në mënyrë që të lehtësojë konfiskimin e të ardhurave të krimit dhe kufizimin e fushës së veprimit të Gjykatës së Krimeve të Rënda, duke bërë të mundur përqendrimin e saj në shkelje penale të lidhura me krimin e organizuar.

Policia kufitare shqiptare përballet me sfida të shumta, duke përfshirë mungesën e

infrastrukturës në materiale. Pikat e reja të kalimit të kufirit që u ndërtuan në vitet 80' tashmë janë në gjendje jo të mirë. Parakusht për të financuar investime të tilla do të jetë që Ministria e Brendshme dhe policia të ndërmarrin hapa për menaxhimin e fazës së ndërtimit, pajisjen me stafin e duhur dhe trajnime me mbështetjen e BE-së. Qeveria do të duhet gjithashtu të sigurojë që investimet të mirëmbahen pas përfundimit të ndërtimit.

Politika e bashkëpunimit e vendit përfitues

Qeveria Shqiptare ka përcaktuar si qëllime ambicioze zbatimin e prioriteteve të partneritetit europian. Zbatimi i strategjisë kombëtare kërkon mbështetje ndërkombëtare për të marrë në konsideratë rekomandimet e parashtruara në « Udhëzimet për zhvillimin e strategjisë për menaxhimin e integruar të kufijve » dhe të tjera rekomandime të dhëna nëpërmjet programit rajonal CARDS. Programi rajonal do të mbështesë rishikimin e strategjive kombëtare për menaxhimin e integruar të kufijve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat do të nxisin rritjen e koherencës dhe qëndrueshmërisë.

Koherenca me NIP/MIP

Drejtësia dhe çështjet e brendshme mbetet një nga sektorët prioritarë kryesorë të ndihmës komunitare për Shqipërinë sipas Dokumentit Strategjik Kombëtar 2002-2006 dhe MIP 2005-2006.

B) Reforma në administratën publike

Historiku

Shqipëria ka përmirësuar proceset e mbikëqyrjes, rekrutimit dhe trajnimit në shërbimin civil, si dhe ka ndërmarrë hapa për përmirësimin e kuadrit ligjor të saj, ndërkohë që përpjekje të konsiderueshme kërkohen për të kufizuar ndërhyrjet e parregullta në emërimet politike, për të përmirësuar pagat dhe strukturën e karrierës, si dhe për të futur menaxhimin e performancave, me synim rritjen e efektivitetit të administratës publike.

Një program për ngritjen institucionale është veçanërisht i nevojshëm brenda Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Plani kombëtar i transportit për Shqipërinë, i cili është botuar në 2005, por ende nuk është miratuar nga Këshilli i Ministrave, ka paraqitur në vija të përgjithshme një numër dobësish me rëndësi të lidhura me kuadrin institucional të sektorit të transportit rrugor dhe ka rekomanduar një strategji zhvillimi institucional për këtë sektor.

Politika e bashkëpunimit

Plani kombëtar i siguron qeverisë udhëzime planifikuese, ndërkohë që lejon planifikim të vazhdueshëm në sektorin e transportit. Rekomandimet dhe veprimet që lidhen me zhvillimin e strukturave institucionale për zbatimin e këtij plani janë të një rëndësie të veçantë.

Koherenca me politikën e bashkëpunimit të BE-së

Disa objektiva lidhen me reformën e përgjithshme të administratës publike. Programet do të zbatohen kryesisht nëpërmjet një programi institucional në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Koherenca me NIP/MIP

MIP 2005-2006, në mënyrë specifike, përmend si një nga qëllimet e saj "përmirësimin e politikës, planifikimit strategjik dhe kuadrin ligjor në fushën e transportit dhe telekomunikacioneve, dhe përmirësimin e zbatimit të ligjeve dhe kapaciteteve administrative të agjencive të zbatimit të politikës së transportit, siç janë drejtoritë e përgjithshme".

C. Decentralizimi

Historiku

Reforma e decentralizimit ka ecur përpara që me miratimin e strategjisë kombëtare për decentralizimin në 1999 dhe ligjin organik për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore në qershor 2000. Shumë funksione dhe përgjegjësi janë decentralizuar në varësi të njësive bashkiake vendore dhe komunave.

Ligjet për inventarizimin dhe transferimin e pronës publike, dhe paketat për decentralizimin fiskal në 2002 përbëjnë një kuadër të fortë ligjor që lejon struktura administrative dhe fiskale të decentralizuara dhe funksionale.

Pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit është ngritur njësia e menaxhimit të programit (PMU), e cila do të menaxhojë programin e zhvillimit të komunitetit lokal CARDS 2001-2002. Projektet e miratuara nga PMU-ja përfshijnë asistencë për rajonet e Shkodrës dhe Lezhës në zbatimin e prioriteteve të tyre për zhvillimin ekonomik dhe social.

Koherenca me politikat e bashkëpunimit të KE-së

Strategjia kombëtare për decentralizimin dhe ligji për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, miratuar përkatësisht në 1999 dhe 2000, përbëjnë bazën e reformës. Rrjedhimisht, shumë funksione dhe përgjegjësi i janë kaluar bashkive dhe komunave.

Ministria e Brendshme (në të cilën përfshihen tashmë qeverisja vendore dhe decentralizimi) dhe Ministria e Financave janë institucionet kryesore qendrore përgjegjëse për zbatimin e reformës së decentralizimit.

INSTAT-i, zyra kombëtare e statistikave, parashikon të zhvillojë një proces dhe sistem analitik rajonal më gjithëpërfshirës, me qëllim që: (i) të japë informacion rreth procesit të decentralizimit; (ii) të rrisë zbatueshmërinë e strategjive të zhvillimit rajonal; (iii) të arrijë pajtueshmërinë e ndarjeve rajonale të Shqipërisë me ato të shteteve anëtare të BE-së.

Koherenca me NIP/MIP

MIP 2005-2006 thekson nevojën për një asistencë më sistematike dhe gjithëpërfshirëse për procesin e decentralizimit në Shqipëri. Rëndësi e veçantë i është kushtuar përmirësimit të kapaciteteve të autoriteteve lokale në ekzekutimin e funksioneve të tyre, duke përfshirë menaxhimin e drejtë financiar dhe strategjitë e zhvillimit. Dokumenti i MIP-së nënvizon rëndësinë e forcimit të kapaciteteve analitike lokale, si dhe mbledhjen e kujdesshme të të dhënave në nivel lokal, me qëllim marrjen e vendimeve më të informuara nga ana e autoriteteve lokale për zhvillimin ekonomik dhe social.

Projekte të identifikuara

Projektet të cilat do të zbatohen në sektorin e mirëqeverisjes dhe ngritjes së institucioneve janë si më poshtë:

Referenca 2.1.1: Reforma e gjyqësorit

Asistencë teknike dhe trajnim për Ministrinë e Drejtësisë dhe gjyqësorin nëpërmjet Misionit të Asistencës Europiane për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë (EURALIUS II).

Referenca 2.1.2: Policia, krimi i organizuar dhe antiterrorizmi

- Mbështetje materiale (pajisje dhe trajnim në lidhje me to) për Policinë e Shtetit Shqiptar në luftën kundër shpërndarjes së lëndëve narkotike dhe për identifikimin e kriminelëve të dyshuar dhe personave në kërkim (p.sh. skaner për gjurmët e gishtave).
- Përmirësimi i infrastrukturës në rajone të veçanta të policisë.
- Mbështetje për infrastrukturën dhe logjistikën në menaxhimin e sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Referenca 2.1.3: Menaxhimi i integruar i kufijve

- Mbështetje materiale (pajisje dhe trajnim në lidhje me to) për policinë kufitare në lidhje me mbikëqyrjen dhe patrullimin e kufirit blu.
- Mbështetje materiale (pajisje dhe trajnim në lidhje me to) për shërbimin doganor shqiptar në shqyrtimin e deklaratave doganore, nëpërmjet shtrirjes së sistemit ASYCUDA në të gjitha zyrat doganore.
- Përmirësimi i infrastrukturës në pika të veçanta të kontrollit kufitar.
- Mbështetje për pastrimin e kufirit verilindor të Shqipërisë nga minat.

Referenca 2.1.4: Azili dhe menaxhimi i migracionit

- Studimi i fizibilitetit për ngritjen e një sistemi të integruar të skanimit të vizave/lejekalimeve (InViS).
- Asistencë teknike dhe mbështetje materiale (pajisje dhe trajnim në lidhje me to) për ngritjen e një Qendre Kombëtare për Vizat pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Reference 2.2.1: Kapacitetet administrative

- Ngritja institucionale në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

Referenca 2.2.2: Decentralizimi

- Programi i zhvillimit të komunitetit vendor
- Mbështetje për menaxhimin vendor të financave publike
- Forcimi i rrjetit të zyrave rajonale të INSTAT-it

Zhvillimi ekonomik dhe social – 15.90 milionë euro

Bashkimi Europian është partneri kryesor në tregti i Shqipërisë, duke përfaqësuar rreth 74% të

totalit të importeve për Shqipërinë dhe rreth 85% të totalit të eksporteve. Defiçiti tregtar i Shqipërisë me BE-në është rritur nga 760 milionë euro në 2003 në rreth 820 milionë euro në vitin 2004.

Për sa i takon zhvillimeve ekonomike, rritja ka vazhduar e sigurt dhe trysnia e inflacionit është mbajtur nën kontroll. Defiçiti i llogarive rrjedhëse është ulur, i mbuluar kryesisht nga remitancat e emigrantëve dhe transferime të tjera private apo zyrtare nga jashtë shtetit, të cilat po forcojnë të ardhurat, si dhe kërkesën vendase.

Tregu i punës është përmirësuar. Në 2005, PBB qëndroi i lartë afërsisht 6%, ndërkohë që akordimi i burimeve në varësi të tranzicionit vazhdoi të nxiste prodhueshmërinë, por pavarësisht nga njëfarë uljeje e varfërisë absolute, ¼ e popullsisë shqiptare vazhdon të jetojë nën minimumin jetik.

Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ka përfunduar, ndërsa privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha ka pasur vonesa. Problem mbetet konkurrenca e pandershme nga bizneset që operojnë në tregun e zi. Niveli arsimor vazhdon të jetë relativisht i ulët dhe krahu i punës i kualifikuar është i kufizuar.

Inflacioni vazhdon të ulet, gjë që pasqyrohet nga vlerësimi i vazhdueshëm i lekut kundrejt euros dhe dollarit amerikan me mbi 2% gjatë 9 muajve të parë të 2005.

Shumica e çmimeve janë liberalizuar. Megjithatë, subvencionet e shtetit akoma aplikohen për çmimet e ujit, arsimimit, transportit hekurudhor dhe energjisë elektrike. Shqipëria ka shënuar progres të ndjeshëm në sektorin energjetik dhe ka liberalizuar sektorin e telekomunikacioneve.

Reforma e tokës ka kontribuar në zhvillimin e sektorit privat, që përbënte rreth ¾ të PBB-së në 2004. Të drejtat e pronësisë mbeten të dobëta, duke dëmtuar potencialin për investime, si dhe aktivitetin ekonomik. Qartësimi i së drejtës së pronës është një kusht thelbësor për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit afatgjatë të tokës. Mungesa e së drejtës së qëndrueshme të pronës pengon zhvillimin ekonomik dhe shton praktikat korruptive.

Për sa i takon standardeve europiane, Shqipëria ka bërë progres në fushat e lidhura me tregun e brendshëm, përkatësisht, duke forcuar standardizimin dhe certifikimin, si dhe duke përmirësuar rregullat në dogana, mbledhjen e detyrimeve doganore dhe legjislacionin tatimor. Hapa pozitivë kanë qenë edhe ngritja e një departamenti për ndihmën shtetërore, masat për përmirësimin e statistikave dhe legjislacioni i ri për pronësinë intelektuale.

Politika bashkëpunuese e vendit përfitues

Ekziston një konsensus i gjerë për elementet kyç të politikave ekonomike. Veçanërisht, është hartuar plani shumëvjeçar për uljen e varfërisë dhe përmirësimin e qeverisjes në kuadrin e strategjisë kombëtare për zhvillimin ekonomik dhe social (SKZHES). Megjithatë, mbetet për t'u parë aftësia e Qeverisë së re për bashkërendimin dhe zbatimin efikas të politikave.

Përsa i përket standardizimit, objektivi kryesor është përafrimi i standardeve ndërkombëtare ISO dhe atyre europiane (EN) si standarde shqiptare. Zyra e re e së Drejtës së Autorit pranë Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave janë përkatësisht përgjegjëse për mbrojtjen e së drejtës intelektuale dhe regjistrimin e patentave.

Ka filluar puna për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Zyra Qendrore për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) është organi përgjegjës për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme.

Në sektorin e bujqësisë, gjëja e gjallë përbën mbi 50% të prodhimeve bujqësore dhe është kaluar legjislacioni për harmonizimin e direktivave të BE-së për sigurinë dhe kontrollin ushqimor. Për sa i takon vitikulturës, vënia në zbatim e normave për klasifikimin e origjinës së verërave etj. pengohet nga mungesa e një kadastre kombëtare për vreshtat dhe verërat.

Në sektorin e infrastrukturës, theksi po vihet në përmirësimin e rrjetit rrugor, ku kalon 95% e të gjithë trafikut shqiptar, pasi linjat hekurudhore janë në kushte tejet të rënduara. Plani kombëtar i transportit përmban një plan investimesh, që përqendrohet në zhvillimin e infrastrukturës rrugore në planin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

Strategjia kombëtare për zhvillimin ekonomik dhe social (SKZHES) thekson se ulja e ndotjes (p.sh. mbetjeve të rrezikshme) përbën prioritet për Qeverinë në sektorin e mjedisit. Masat janë edhe detyrime nga marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë, si dhe të nevojshme për përafrimin e legjislacionit të mjedisit me acquis.

Zhvillimi ekonomik dhe social, siç pasqyrohet në axhendën e procesit të stabilizim-asociimit dhe në strategjinë kombëtare për uljen e varfërisë, është forcuar nëpërmjet bashkëpunimit të Shqipërisë me partnerët e huaj. Pika kyçe e saj është hartimi i një politike kombëtare për punësimin, veçanërisht përfshirja graduale e standardeve ndërkombëtare të punës. Shqipëria është palë në disa

konventa ndërkombëtare me objekt reformën në arsim dhe punësim.

Koherenca me NIP/MIP

Një nga prioritetet në kuadrin e dokumentit aktual të MIP-it është zhvillimi ekonomik dhe social dhe një prej mënyrave për arritjen e këtij prioriteti është përmirësimi i klimës për investimet. Qëllimi është përmirësimi dhe vënia në zbatim e legjislacionit në këtë fushë, në mënyrë që të përmirësohet funksionimi i tregut dhe të rritet konkurrenca. MIP i kushton rëndësi të veçantë ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, i cili mund të realizohet në nivel të kënaqshëm vetëm nëpërmjet një sistemi efikas të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

MIP mbulon edhe fushën e infrastrukturës, me objektiv lehtësimin e institucioneve financiare ndërkombëtare, IFIs apo donacioneve të tjera për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës kryesore në Shqipëri, me qëllim që të kontribuojë në nxitjen e tregtisë dhe rritjes ekonomike. Këto objektiva arrihen nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të rrjetit kryesor të transportit në Shqipëri dhe asistencës teknike për infrastrukturën e shkallës së gjerë, e cila jepet nga IFIs apo/dhe donatorë të tjerë.

Programet që do të zbatohen do të përqendrohen në "asistencë për studimet e fizibilitetit dhe mbikëqyrjen e punimeve në infrastrukturë, me qëllim lehtësimin e financimeve të mëtejshme nga IFIs dhe/apo donatorë të tjerë për përmirësimin e rrjetit kryesor të transportit".

Në lidhje me mjedisin, në dokumentin e MIP-së shprehet qartë se asistenca e ofruar duhet të jetë në vazhdimësi të rezultateve të pritshme nga projektet ekzistuese të CARDS-it dhe progresit të arritur nga Qeveria në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e mjedisit, me synim përafrimin e acquis.

Në dokumentin e MIP-it theksohet se prioritet për sistemin e arsimit të lartë në të gjitha vendet e Europës Juglindore mbetet arritja e objektivave të "Deklaratës së Bolonjës", e cila synon të vendosë një hapësirë të përbashkët europiane për arsimin e lartë deri në 2010. Shqipëria ka nënshkruar Deklaratën e Bolonjës në shtator 2003.

Përsa i përket punësimit, në dokumentin e MIP-it nënvizohet nevoja për nxitjen e nevojave të tregut të punës dhe të arsimit dhe formimit profesional (AFP), si dhe reformimi dhe përmirësimi i sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri.

Projekte të identifikuara

Projektet të cilat do të zbatohen në sektorin e zhvillimit ekonomik dhe social janë si më poshtë:

Referenca 3.1: Klima e investimeve

- Shtrirja e shërbimeve të regjistrimeve të paluajtshme në zonat bregdetare

Referenca 3.2: Tregtia

- Mbështetje për infrastrukturën e cilësisë
- Përmirësimi i rendimentit të sektorit të gjësë së gjallë
- Krijimi i kadastrës shqiptare të verës
- Mbrojtja e së drejtës së autorit dhe mbështetja për patentat industriale

Referenca 3.3: Infrastruktura

- Projektimi i detajuar dhe dokumentet e tenderimit për një segment të korridorit Durrës-Kukës-Morinë
- Menaxhimi i urave
- Studim për transportin në rajonin Tiranë-Durrës dhe ndërlidhja midis korridoreve veri-jug dhe lindje-perëndim

Referenca 3.4: Mjedisi

- Mbështetje për zbatimin e planit kombëtar për përafrimin e legjislacionit në fushën e mjedisit
- Pastrimi, mbledhja, paratrajtimi, trajtimi dhe eliminimi i mbetjeve të rrezikshme

Referenca 3.5.2: Punësimi

- Mbështetje për përmirësimin e veprimtarive të shkollave pilote profesionale dhe qendrave rajonale të AFP-së.

Programet komunitare – 0.70 milionë euro

Një hap përpara drejt integrimit në BE është dhe hapja e programeve komunitare për

Shqipërinë. BE ra dakord në Axhendën e Selanikut të hapë pjesëmarrjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor në programet komunitare, duke ndjekur modelin e zgjerimit.

Komisioni propozoi hapa konkretë për të mundësuar pjesëmarrjen, duke nënvizuar nevojën për një përqasje graduale dhe përzgjedhëse. Kontributi financiar i Shqipërisë, "bileta hyrëse", i nevojshëm për të mbuluar shpenzimet e pjesëmarrjes së saj në programe të tilla, mund të paguhet pjesërisht nëpërmjet buxhetit të programit CARDS, bazuar në një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit.

Një marrëveshje kuadër me Komunitetin Europian, që vendos kushtet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet komunitare, u nënshkrua në nëntor 2004 dhe u ratifikua nga të dyja Palët në maj 2005.

Konkretisht, dokumenti i MIP-it parashikon mbështetje për Shqipërinë dhe angazhimin e saj në programet komunitare nëpërmjet dy masave:

- duke paguar një pjesë të kostos së "biletës hyrëse" për Shqipërinë;
- duke bashkëfinancuar masat shoqëruese, si përgatitjet administrative, komunikimi dhe trajnimi i aplikantëve të mundshëm në përgatitjen e propozimeve.

Duke pasur në konsideratë përgatitjen e kufizuar të Shqipërisë për të marrë pjesë në programet komunitare, do të jetë e nevojshme të vendosen prioritete dhe të përqendrohet fillimisht në programe për të cilat nevojiten kapacitete administrative më të pakta.

2. KOSTOJA DHE FINANCIMI

Përmbledhje e alokimeve të AP-së

FUSHA/PROJEKTI PRIORITAR	EURO
1. STABILIZIMI DEMOKRATIK	
Ngritja e kapaciteteve për OJF-të	1,600,000
2. MIRËQEVERISJA DHE FORCIMI I INSTITUCIONEVE	
Mbështetja për reformën e gjyqësorit në Shqipëri (EURALIUS II)	4,500,000
Policia, krimi i organizuar dhe antiterrorizmi	2,000,000
Menaxhimi i integruar i kufijve	5,500,000
Azili dhe menaxhimi i migracionit	3,000,000
Reforma e administratës publike: Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	1,000,000
Mbështetje për decentralizimin	5,000,000
Statistikat dhe decentralizimi fiskal	3,300,000
3. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE SOCIAL	
Përmirësimi i klimës së investimeve: regjistrimi i pasurisë së paluajtshme	1,900,000
Përmirësimi i klimës së biznesit	4,000,000
Projektimi dhe mbikëqyrja e disa segmenteve rrugore dhe menaxhimi i urave	2,000,000
Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme dhe përafrimi i legjislacionit	5,000,000
Arsimi profesional dhe trajnimi, Inspektorati Shtetëror i Punës	3,000,000
4. HAPJA E PROGRAMEVE KOMUNITARE	
Mbështetja për pjesëmarrjen e Qeverisë së Shqipërisë në programet komunitare	700,000
TOTALI	42,5 mil. euro